

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me Gjyqtarin Drilon HARAÇIA, me sekretaren juridike Valbone Hoxha, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “K. e R.” – Prishtinë, kundër të paditurit F. H. nga fsh. R., Komuna e Gjakovës, për regresimin e dëmit, vlera e kontestit 180,00 €, jashtë shqyrtimit me dt.07.04.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)

MIRATOHET në tërësi kërkesë – padia e paditëses Kompania e Sigurimeve “K. e R.” – Prishtinë, ashtu që të **DETYROHET** i padituri F. H. nga fsh.R., Komuna e Gjakovës, që në emër të regresimit të dëmit t’ia paguaj shumën prej **180,00€**, me kamatën përkatëse ligjore 8 % në vite, e cila fillon të rrjedhë nga dt.23.01.2017 (parashtrimi i padisë) e tutje, e deri në pagimin definitiv, paditëses si dhe në emër shpenzimeve procedurale shumën prej **30,00 €**, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pala paditëse në padi ka theksuar se me dt.05.04.2015 rreth orës 13:20 min në rr. “Wesli Clark” ka ndodhur aksidenti i komunikacionit me dëme materiale dhe jo materiale në të cilin aksident kanë qenë të involvuar dy aksidente, ku deri te aksidenti ka ardhur me fajësinë e drejtuesit të automjetit VW Golf me targa ..., i siguruar nga paditësja, ku i padituri ka drejtuar automjetin pa patentë shofer. Paditësi me dt.22.07.2015 ka arritur marrëveshje me të dëmtuarin dhe i njëjti është kompensuar në shumën e përgjithshme prej 180.00€, ku kjo shumë është paguar me dt.06.08.2015. andaj duke pasur parasysh se i siguruari i paditëses ka shkaktuar aksident trafikku ku shoferi F. H. ka qenë pa patentë shoferi, atëherë në bazë të Ligjit për Sigurimin e Detyruar të Automjeteve dhe të LMD-së, shoferi është i detyruar të paguaj shumën e lartcekur.

Gjykata në kuptim të nenit 394 të Ligjit për procedurën kontestimore nr.38/2008 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” me dt.20.09.2008, i ka dërguar të paditurit padinë dhe Aktvendimin për dhënien e përgjegjës në padi.

Duke e bërë shikimin në flete dërgesën për dorëzim personal konstatohet se i padituri i lartpërmendur e ka pranuar personalisht Aktvendimin C.nr.36/17 të dt.15.02.2017, padinë dhe provat me dt.04.02.2017, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjegjës në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150.1 të LPK-së, të larte cituar Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet siç më poshtë vijnë:

- a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja-aktvendimi për dhënien e përgjegjës në padi,
- b) Themelësia e kërkesë-padisë rezulton nga faktet e treguara në padi, dhe

c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Andaj, në kuptim të nenit 160.6 të Ligjit për procedurën kontestimore janë dhënë vetëm arsyet e sipërcituara që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u vendos komfor nenit 452.1 të LPK, me ç ‘rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet në emër të taksave gjyqësore shumë prej 30,00 €.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.36/17, me dt.07.04.2017.

GJYKATËSI,
Drilon HARAÇIA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.